

VENDIM
Nr. 136, datë 26.11.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË
RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 99, 109, pikat 4 dhe 5; 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përafrimit të kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Organi i administratës në ushtrimin e funksioneve të tij e në zbatim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe të proporcionalitetit.

- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e një ndryshimi në kapitullin IX.1.3, germa “g”, të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, me përmbajtjen si më poshtë:

“Duke filluar nga 1 janari 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti